

FJALA E DEPUTETIT PETRIT VASILI

E ENJTE 15 SHTATOR 2022

E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot është lajm i mirë që diskutojmë për programin, fondet IPA dhe praninë e mëtejshme të Europës në realitetin tonë. Pa diskutim që ka një kontrast të fortë midis këmbënguljes europiane për të na mbështetur, për të na financuar dhe asaj se si silllet qeverisja me këtë qëndrim europian, çfarë bën ajo për ta përfituar këtë gjë dhe ç'bën ajo për ta penguar këtë prezencë europiane. Është fare e qartë që në tërësinë e vet qeverisja e këtij vendi nuk është e interesuar të thithë fonde europiane dhe për këtë arsye ul gjithmonë e më shumë kapacitetet e administratës e i zëvendëson me njerëz që nuk kanë fare të bëjnë me punën.

Nga ana e nivelit teknik, në dhjetëra dhe qindra raste janë pak të thuash mediokër, por, sigurisht, janë ustallarë të mirë për t'u marrë me Facebook-un dhe për të bërë like dhe share, por thithja shumë e ulët e fondeve, gati gjysmë për gjysmë me mesataren e tyre disavjeçare, është provë. Pra, qeveria nuk ka prioritete dhe ndërmjet një torollaku, që bën like gjithë ditën në kompjuter, dhe një teknikieni të pazëshëm, por që shërben mirë, zgjedh gjithmonë të parin. Kjo është zgjedhja që kanë bërë. Shkollëpakësia preferon idiotësinë. E vërteta është se situata është goxha e komplikuar dhe po rëndohet gjithnjë e më tepër.

Po çfarë raporti do të ndërtojmë me një Europë, e cila është bujare ndaj nesh? Duhet të flasim me fakte konkrete. Nuk kemi nge të dëgjojmë më dëngla propagande. Ca që janë më të rinj mbase kanë oreks t'i dëgjojnë, por ne që kemi një moshë të caktuar, kemi dëgjuar edhe përpara '90-ës dhe kemi parë që fundi i propagandës është shumë i dhembshëm, i mjerueshëm, por edhe i turpshëm dhe tërë ata, që i kanë bërë shërbim propagandës, kanë rezultuar qenie thjesht të neveritshme dhe kaq. Çfarë ka ndodhur normalisht?! Na duhen këto fonde europiane; patjetër që na duhen, se janë jetike për ne. Po çfarë të bëjmë ne?!

Europa na thotë qartë se çfarë raporti ka ajo me amnistinë e kësaj qeverie, thjesht dhe vetëm bërjen e lavatriçes së madhe, pastrim të parave me ligj. Është kundër. Jo, - thotë qeveria, - do të vazhdojmë përpara, se nuk na duhen fondet tuaja, se ne vemi lart e poshtë nëpër Lindje dhe gjejmë para, lloje-lloje. Shtrëngohemi, puthemi dhe përqafohemi me lloj-lloj zuzarësh të zinj në çdo pikëpamje, boll e boll të mos i nënshtrohemi rigorozitetin europian, korrektesës europiane dhe transparencës deri në fund të Europës. Çfarë na thotë Europa? Na thotë: mos e bëni në këtë mënyrë, siç po bëni portin e Durrësit, mos e shkelni MSA-në! Jo, thonë kokorroçët, e bëjmë, nuk pyesim fare, se kemi gjetur disa ortakë lart e poshtë në botë të tjera dhe kjo bota europiane nuk na duhet. Këto janë faktet.

Propagandat dhe dënglat le t'i mbajnë për vete. Këto janë të vërtetat, e zeza në të bardhë. U shpreh Europa: mos vini dorë! Mos e shembni trashëgiminë kulturore! Mos e prekni teatrin! Po kokorroçët, idiotë 415 karatë, shkollëpakë, por edhe hajdutë, vajtën e i qëlluan. Nuk pyetën për Europën fare. Nuk u ndalën për Europën. Europa na tha tjetër që të ndërtojmë një transparencë të madhe publike, shërimi i vetëm për një shoqëri pluraliste, të mos i bëjmë presion medias. Tërhiquni! Mos u merrni më me atë ligj, por këta vazhdojnë, agjitpropët e paranëntëdhjetës, këta apogjejtë e nenit 55 të agjitacion-propagandës, sa e detyruan Europën të shkojë në Këshillin e Europës dhe në institucionet përkatëse e të thotë: “Ndaluni, o të marrë!

O idiotë, ndaluni, se këto janë idiotësira të paranëntëdhjetës, që janë lënë pas!” Pse është ky raport me Europën? Ky raport është, sepse transparenca europiane është kundër hajdutërisë, është për transparencën, është për ekonomizimin e çdo leku publik, por kjo qeveri përpiqet ta pengojë sadopak këdo që hedh dritë mbi aferat e fëlliqura e të qelbura. Është si ata, që pësojnë një alergji të menjëhershme, tërbohen, skuqen, xhindosen, sepse, sigurisht, nuk kemi si të kemi raport me Europën, kur kjo qeveri ka futur termin “i mrekullueshëm” për tenderët sekretë dhe vjedh varda me ta. Se si mund të ketë qindra procedura tenderimi?! Ta dinë shqiptarët që, kur prokurohen 4 milionë e ca euro, ai kandidati i vetëm që e merr tenderin, e ul 15 euro.

Futeni në kokë të gjithë, edhe ju që votoni e bëni propagandë paturpësisht gjithë ditën, nga 4 milionë e ca euro e ul 15 euro. Me 99, 9% të çmimit i japin tenderët. Këto janë faktet. Këto përrallat “ne duam këtë, duam këtë kontinent” le t'i harrojnë të gjithë. Këto janë të vërtetat e

zeza mbi të bardhë. Europa ka thënë: ndalini koncesione e PPP, se ka dalë borxhi publik jashtë kontrollit; ka dalë ekonomia jashtë kontrollit. Futini këto koncesioni dhe borxhe në llogarinë e madhe publike! Jo, nuk i fusim ne, - thatë, - se ne kemi ligje tonat financiare talebane, që nuk i fusim, dhe Europës qindravjeçare, e cila ka eksportuar kulturë nga të gjitha anët e botës, nuk i intereson, se këta mund të venë me qetësinë më të madhe e të thonë se kemi gjetur një ligj në Somali, në Zimbabve, në një cep të globit dhe ai ligji i lejon të vjedhim.

Këto janë standardet europiane. Për këtë arsye edhe paratë, qindra milionë euro, nuk absorbohen, sepse është bashkuar hajdutëria me mungesën e totalit të kapacitetit. Nuk kanë faj, sepse nëpër dikastere mbeten nga një, nga dy, se nuk mban dot në punë 20 budallenj të tjerë që bëjnë like e share gjithë ditën, se nuk dinë të bëjnë gjë tjetër dhe faktet janë aty. Sigurisht që Europa nuk mund të pajtohet me pasigurinë dhe tronditjen themelore të sigurisë juridike në këtë vend, që nuk ofron asnjë lloj garancie, asnjë lloj biznesi serioz dhe, sigurisht, Shqipëria e di shumë mirë që është ndarë prej kohësh me biznese të mëdha e serioze dhe fakti që shumë biznese shqiptare shkojnë në Kosovë, e shpjegon këtë gjë.

Është shumë i qartë edhe standardi që ka kjo qeveri: një Shqipëri që zhvillohet sipas tyre, që ka zhvillim, sepse ka krim; këtu do të përfundojë. Çdo shoqëri, edhe ajo Europa ku duam të shkojmë, është zhvilluar, se ka qenë Europë e mendjes, e iluminizmit, ndaj ka këtë standard që rrezaton një standard botëror ekonomik dhe demokratik për t'u marrë shembull nga i gjithë globi, por nuk e duan dhe në këtë moment, në vend që të kemi para për arsimin dhe standarde të larta që të sigurojmë edhe të ardhmen, kemi pedagogët në grevë. Çfarë kërkojnë pedagogët?

Ata nuk kërkojnë rrogën as të pedagogut francez, as italian, as belg, as holandez, as spanjoll, as anglez, por të jetë sa niveli i Kosovës, maksimumi kaq po kërkojnë, rrogën e Kosovës, e cila ka më pak vjet qeverisje se Shqipëria, e cila ka 100 e ca vjet pavarësi. Shtet i vjetër Shqipëria; buxhet goxha më të madh Shqipëria, por nuk ka para për pedagogët; nuk e bën dot rrogën e pedagogëve sa Kosova, nuk e arrin dot standardin e Kosovës, fare-fare! Edhe për çdolloj lëmoshe, që u kanë dhënë pedagogëve, edhe në qoftë se u kanë dhënë diçka dikur, ua kujtojnë atë: keni marrë diçka 20 vjet më parë. Ndërkohë, çfarë ka Shqipëria? Ka analfabetizmin më të madh funksional, pra ka budallenj me dëftesë, që dinë shkrim e këndim, por nuk kuptojnë.

Kjo është Shqipëria që po projektoni, prandaj mijëra e mijëra studentë sakrifikojnë familjet. I keni parë të dhënat, janë me mijëra ata që shkojnë e studiojnë në Itali, Francë, Holandë e gjetkë? Pse duhet të studiojnë jashtë vendit, kur fare mirë mund të studionin këtu?! Pra, është shumë e qartë se interesi për të pasur Europë të vërtetë nuk ekziston, interesi i vetëm është që të funksionojë lavatriçja e parave të pista, ku vazhdojmë të jemi në listën gri apo të zezë të Europës dhe Europa duhet të rrijë sa më larg, sepse sa më afër të jetë, aq më shumë dritë ka mbi korrupsionin e zi, të errët, prej miliardash, të një qeverie të pangopur.